



ÇËSHTJA E PRESIDENTIT: LV-ja BËN THIRRJE PËR BASHKËPUNIM, PDK-ja DHE AAK-ja AKUZOJNË PUSHTETIN PËR ZVARRITJE TË PROCESIT

FACE 4-5



AKTUALE



**KURTI DHE HARADINAJ
PËRPLASEN ASHPËR NË KUVEND
PËR MEDIET DHE ENERGJINË** F. 3

**GLPS-ja: MOSEMËRIMI
I SEKRETARIT TË KUVENDIT DHE
VENDIMI PËR RISHPALLJE TË
KONKURSIONIT, SHKELJE LIGJORE** F. 5

**LDK-ja BËHET ME TRE
SEKRETARË PARTIE** F. 6

EKONOMI



**KUVENDI RATIFIKON DISA
MARRËVESHJE FINANCIARE
NDËRKOMBËTARE** F. 8

**RAPORTI I FMN-së: EKONOMIA
E KOSOVËS PO RRRITET
MË NGADALË** F. 8

SPORT



**NORA GJAKOVA NIS KAPITULL TË
RI, KAMPIONIA OLIMPIKE BËHET
TRAJNERE E XHUDOS NË BELGIKË** F. 11

Lëvizja Vetëvendosje ka bërë thirrje për bashkëpunim ndërpartiak për zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës ndonëse nuk ka ndërmarrë

asnjë hap që nga aktgjykimi i Kushtetueses. Lideri i LV-së dhe kryeministri Albin Kurti ka thënë se vendi nuk ka luks për vonesa dhe bllokada,

ndërsa PDK-ja dhe AAK-ja e kanë akuzuar partinë në pushtet se është duke e zvarritur qëllimshëm procesin e zgjedhjes së presidentit



**PDK-ja KRITIKON LV-në:
REFUZIMI PËR T'I DHËNË
PRIORITET REZOLUTËS,
SHMANGIE E PËRGJEGJËSISË
NDAJ SË VËRTETËS
HISTORIKE** F. 3



**GJERMANIA
NDIHMON FSK-në
ME TRE MILIONË
EURO DONACION** F. 6

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AGK-ja dënon retorikën nxitëse dhe akuzuese të Kurtit kundër medieve dhe gazetarëve

PRISHTINË, 2 PRILL - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka dënuar ashpër deklaratat e Albin Kurtit ndaj medieve dhe gazetarëve. Kurti nga foltorja e Kuvendit paralajmëroi për "hyrjen e parave në mënyrë të padukshme" dhe tha se dezinformimi "vjen direkt nga armiqët", me "argatë brenda vendit". AGK-ja e ka cilësuar

këtë gjuhë nxitëse dhe stigmatizuese, duke theksuar se etiketimi të tilla rrezikojnë lirinë e medias.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në foltoren e Kuvendit të Kosovës këtë të enjte ka sulmuar mediet dhe gazetarët, duke folur, mes të tjerash, për "hyrjen e parave në mënyrë të padukshme". Kryeministri në

fjalën e tij ka thënë se "një qytetar i dezinformuar nuk është një qytetar i lirë, por është i manipuluar dhe, siç tregojnë raportet, ky manipulim po vjen direkt nga armiqët tanë por, fatkeqësisht, po gjejnë edhe argatin e tyre brenda vendit tonë". AGK-ja e dënon fuqishëm këtë retorikë nxitëse dhe akuzuese të Kurtit kundër

medieve dhe gazetarëve në Kosovë, duke i vlerësuar ata 'argatë të armiqve'. Një gjuhë e tillë është vazhdimësi e fushatave të paseshura të Kurtit, partisë dhe qeverisë së tij, kundër gazetarëve dhe medieve, me synim minimin e raportimit të pavarur dhe të lirë", është thënë në reagimin e AGK-së.



AHMETI: GJUHA SHQIPE NUK DO TË JETË KURRË ÇËSHTJE NEGOCIMI

SHKUP, 2 PRILL - Gjykata Kushtetuese në Maqedoninë e Veriut ka riaktivizuar përpjekjet për ta shqyrtuar Ligjin e Gjuhës që kufizon zbatimin e gjuhës shqipe në vendin fqinj. Pas këtij vendimi të Kushtetueses, ka reaguar kryetari i Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, i cili përmes një letre të hapur ka theksuar se statusi i gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare në Maqedoninë e Veriut është i panegociueshëm dhe pjesë e pandashme e rendit kushtetues të shtetit.

Ahmeti vlerëson se shtetet e qëndrueshme ndërtohen mbi parime të qarta, marrëveshje politike të mëdha dhe respekt të ndërsjellë mes qytetarëve. Ai ka nënvizuar se çështje të tilla si përdorimi i gjuhës shqipe nuk duhet të bëhen objekt i debateve të përditshme politike apo rivaliteteve partiake. Duke iu referuar Marrëveshjes së Ohrit, ai ka theksuar se kjo marrëveshje përbën themelin e shtetit dhe se çdo përpjekje për ta vënë në pikëpyetje rrezikon të ardhmen e tij. Sipas tij, gjuha shqipe nuk është privilegj, por e drejtë e garantuar me Kushtetutë.

Ahmeti ka thënë se barazia



gjuhësore është thelbësore për bashkëjetesën dhe stabilitetin, duke shtuar se shqiptarët nuk e kanë kontestuar asnjëherë gjuhën maqedonase apo identitetin maqedonas. Përkundrazi, sipas tij, ata kanë kontribuar në ndërtimin e një shteti të përbashkët,

euroatlantik dhe demokratik. "Gjuha shqipe për mua nuk është dhe nuk do të jetë kurrë çështje negociimi. E kam thënë dhe do ta përsëris pa asnjë rezervë: Marrëveshja e Ohrit është themel i këtij shteti dhe kush e vë në pikëpyetje atë, vë në pikëpyetje vetë ardhmen e

tij. Shqipja nuk është privilegj, por e drejtë e fituar dhe e garantuar me Kushtetutë. Çdo tentativë për ta relativizuar apo kufizuar këtë të drejtë është një përballje e drejtpërdrejtë me rendin kushtetues dhe nuk do të kalojë pa përgjigje. Shqiptarët në këtë vend nuk e

kanë kontestuar asnjëherë gjuhën maqedonase dhe identitetin maqedonas; përkundrazi, janë përcaktuar vazhdimisht për një Maqedoni të përbashkët, unitare, euroatlantike dhe evropiane. Kjo është e vërteta që duhet thënë qartë: barazia e shqiptarëve nuk e ka dobësuar shtetin, por e ka forcuar atë. Nuk e ka cenuar bashkëjetesën, por e ka bërë më të drejtë. Nuk e ka lëkundur orientimin perëndimor të vendit, por e ka bërë të mundur. Një shtet që nuk u flet qytetarëve të vet në gjuhën e tyre, nuk është shtet i barabartë. Shqipja nuk është barrë për shtetin, është realitet i tij dhe pjesë e pandashme e identitetit të tij institucional. Prandaj, çdo përpjekje për ta relativizuar, reduktuar apo dobësuar statusin e gjuhës shqipe nuk është thjesht debat juridik. Është prekje e një ekuilibri të ndërtuar me shumë mençuri politike, me shumë përgjegjësi dhe me shumë përkushtim për të ardhmen e përbashkët. Të reduktosh të drejtat gjuhësore do të thotë të reduktosh besimin. E kur cenohet besimi, dëmtohet vetë kohezioni i shtetit", ka thënë Ahmeti.

Meka po bëhet me aeroport, pelegrinët do të udhëtojnë më shpejt në Haxh

RIAD, 2 PRILL - Një zyrtar saudit ka konfirmuar se Meka, qyteti më i shenjtë i Islamit, së shpejti do të ketë një aeroport. Në një intervistë me "Harvard Business Review Arabia", Saleh Al-Rasheed, drejtor ekzekutiv i Komisionit Mbretëror për Qytetin e Mekës dhe Vendet e Shenjta (RCMC), ka thënë se "udhëzimet strategjike, ekonomike dhe të investimeve për Aeroportin e Mekës janë miratuar". Ai ka thënë se si pjesë e këtij projekti, Komisioni Mbretëror, një entitet

qeveritar i ngarkuar me zhvillimin, planifikimin dhe shërbimet në Mekë dhe vendet e shenjta përreth, do të punojë me sektorin privat për të zhvilluar një model të përshtatshëm për investimin e projektit. Meka aktualisht nuk e ka aeroportin e vet ndërkombëtar funksional. Megjithatë, në vitin 2024, Mbretëria e Gjirit ka eksperimentuar me mjete ajrore autonome elektrike për ta eksploruar potencialin për lehtësimin e udhëtimit në raste emergjence, si dhe për të shpërndarë pajisje mjekësore.

Në vend të kësaj, shumica e vizitorëve ndërkombëtarë zgjedhin të fluturojnë për në Aeroportin Ndërkombëtar të Mbretit Abdulaziz në Xheda, i cili është afërsisht 100 km larg qytetit të shenjtë, dhe të udhëtojnë pjesën tjetër të rrugës për në Mekë me rrugë tokësore. Raportohet se terreni malor i Mekës paraqet sfida për udhëtimin ajror, duke përfshirë turbulencë, qasje të vështira dhe probleme të mundshme me dukshmërinë dhe motin. Në vitin e kaluar Arabia Saudite ka pritur më shumë se 1.5 milion pelegrinë të huaj për



Haxh, të cilët kanë mbërritur nga jashtë vendit përmes pikave të ndryshme të hyrjes, sipas të dhënave nga

Autoriteti i Përgjithshëm për Statistika (GASTAT). Në total kishte më shumë se 1.6 milion pelegrinë.

KURTI DHE HARADINAJ PËRPLASEN ASHPËR NË KUVEND PËR MEDIET DHE ENERGJINË

PRISHTINË, 2 PRILL - Fjalimin e tij në Kuvendin e Kosovës, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ua drejtoi disa medieve. Kurti duket se nuk ka mundur t'i pranojë kritikën nga Këshilli i Evropës, duke eskaluar të enjten në akuza më të rënda ndaj medieve në Kosovës.

Kurti ka përmendur akuzat që nuk mbështetën në asnjë fakt, lidhur me thasë me para që kanë marrë gazetarët. "Nëse shteti duhet të jetë i drejtë në ekonomi, duhet të jetë po aq i drejtë në hapësirën publike. Këtu hyn një tjetër çështje që nuk mund të anashkalohet. Mediet. Një demokraci jeton nga fjala e thënë. Kjo duhet të jetë e lirë për të qenë e vlefshme. Fjala nuk mund të jetë e lirë nëse është e kapur nga interesa të fshehta. Raportimet për thasë parash janë kërcënim për integritetin e debatit publik. Sepse kur paraja hyn në mënyrë të padukshme, ajo blen ndikim, orienton narrativën, deformon perceptimin e qytetarit", është shprehur Kurti.

Ai ka thënë se në Kosovë ka persona që po ia bëjnë argatin Serbisë. "Një qytetar i dezinformuar nuk është i lirë. Është i manipuluar. Ky manipulim po vjen nga armiqët tanë, dhe po gjejnë argatin e tyre brenda vendit tonë. Ne nuk kemi asnjë interes t'i kufizojmë mediet. Por pavarësia nuk mund të ndërtohet mbi fshehtësi që financojnë shpifjen dhe dezinformimin, liria editoriale është e garantuar, por duhet të jetë me transparencë të financimit. Kush flet, nga kush financohet, me çfarë burime flet. Nëse secili biznes jep përgjegjësi për financat, mediet duhet të jenë në të njëjtin nivel të përgjegjësive. Nëse në diktaturë kontrollohen rezultatet, sot nga oligarkia ka rrezik të kontrollohen premisat. Grupet e interesit nuk e prekin lirinë e shprehjes. Ato kontrollojnë ekonominë e medias", ka thënë Kurti.

Ndaj Kurtit ka reaguar ashpër lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj. Ai e ka akuzuar

Kurtin se është duke financuar "zagarë" për t'i fyer shqiptarët. Po ashtu, Kurti e ka akuzuar Kurtin edhe për vjedhjet në energji. "Edhe sot erdhi mashtruesi, me mashtrim ideal. Mashtrimi nuk është fyerje. Ndodhi një mashtrim në këtë foltore. E para, kolegu që foli para meje është që sa vjet në pushtet, mban përgjegjësi për çmimet, për vjedhjen në energji dhe për faturat. Nuk mund t'i ikni kësaj përgjegjësie. Oligarkët tu po shesin e po blejnë energji. E dyta, po financohen mediet me thasë. Dëgjojeni çfarë po thotë: 'mediet po financohen me thasë'. Ky shpenzon më së shumti para duke ushqyer zagarë që fyejnë shqiptarë", ka thënë Haradinaj.

Akuzat e Kurtit për mediet kanë ngjallur reagime të mëdha në Kosovë, duke përfshirë politikanë dhe përfaqësues të medieve. Deputetja e PDK-së, Ariana Musliu-Shoshi, e ka cilësuar të rrezikshme deklaratën e kryeministrit Albin Kurti lidhur me mediet, duke i



etiketuar "argatë të brendshëm". Musliu-Shoshi ka thënë se kjo është një përpjekje e Kurtit për ta delegjitimuar fjalën e lirë dhe për t'i frikësuar zërat kritikë në vend. "Kur kryeministri flet për 'thasë parash', për 'argatë të brendshëm' dhe për 'ndikime të fshehta', pa ofruar asnjë fakt konkret dhe pa ndjekur rrugë institucionale, ai nuk po mbron demokracinë, por ai po ndërton

një narrativë të rrezikshme kundër medieve. Kjo nuk është transparencë. Ky është presion politik i maskuar si shqetësim etik. Në një demokraci funksionale, akuzat për financime të paligjshme nuk bëhen nga podiumet politike për konsum publik, por adresohen në institucionet e drejtësisë", ka thënë Musliu-Shoshi.

PDK-ja KRITIKON LV-në: REFUZIMI PËR T'I DHËNË PRIORITET REZOLUTËS, SHMANGIE E PËRGJEGJËSISË NDAJ SË VËRTETËS HISTORIKE

PRISHTINË, 2 PRILL - Nënkrutarja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Vlora Çitaku, në seancën plenare të Kuvendit ka propozuar një draft-rezolutë për mbrojtjen e së vërtetës dhe viktimave të luftës. Ajo ka thënë se sot Kosova po përballet me përpjekje për shtrembërimin e historisë së vendit, duke iu referuar ekspozitës skandaloze, e cila ishte paraqitur në Prishtinë, por që është larguar për shkak të pasaktësive. Me këtë rast, Çitaku ka kërkuar që ky dokument të diskutohet në fillim të seancës, por Lëvizja Vetëvendosje është pajtuar. Për shkak të kësaj, PDK-ja ka lëshuar seancën e Kuvendit, ku më vonë ka lëshuar një reagim publik.

Kjo parti ka kritikuar LV-në, e cila nuk ka pranuar të enjten të futet si pikë e parë e rendit të ditës rezoluta e tyre, e cila kishte për qëllim dënimin e ekspozitës së Shkëlzen Gashit. Përmes reagimit, PDK-ja veprimin e LV-së e ka vlerësuar shmangie e përgjegjësisë ndaj së vërtetës historike dhe dinjitetit të viktimave të luftës. "PDK-ja ka kërkuar që kjo rezolutë të përfshihet si pikë e parë e rendit të ditës në seancën e Kuvendit, duke pasur parasysh ndjeshmërinë dhe urgjencën që lidhet me zhvillimet e fundit dhe reagimin e drejtë institucional ndaj tyre. Fatkeqësisht, grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje nuk e ka mbështetur këtë kërkesë, duke refuzuar që Rezoluta të trajtohet



me prioritetin që meriton. Në këto rrethana dhe për ta shmangur një votim të paracaktuar për dështim, PDK është detyruar ta tërheqë përkohësisht këtë Rezolutë nga procedura parlamentare dhe të lëshojë sallën e Kuvendit", është thënë në reagimin e PDK-së. "PDK-ja vlerëson se refuzimi për ta trajtuar këtë çështje si prioritet nuk është një vendim procedural, por një shmangie nga përgjegjësia institucionale për ta mbrojtur të vërtetën historike dhe për ta respektuar dinjitetin e viktimave të luftës. Rezoluta e propozuar nga PDK synon të dënojë çdo shtrembërim të fakteve historike, të kërkojë përgjegjësi për keqinformimin dhe të garantojë standarde të qarta institucionale në trajtimin e historisë së luftës së Kosovës. Partia Demokratike e Kosovës mbetet e vendosur që këtë çështje ta rikthejë në

Kuvend dhe të kërkojë mbështetje të gjerë politike dhe shoqërore për miratimin e saj. Mbrojtja e së vërtetës historike nuk është çështje e një partie, por detyrim ndaj shtetit, ndaj viktimave dhe ndaj brezave që vijnë", është thënë në reagimin e PDK-së.

Hasani: Ekspozita me pasaktësi për masakrat nuk është gabim, por version i qëllimshëm i UDB-së

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Nait Hasani, ish-i burgosur politik, ka thënë se ekspozita me pasaktësi për masakrat gjatë luftës në Kosovë "nuk është vetëm gabim". Ai ka thënë në Kuvendin e Kosovës se do ta flasë "një të vërtetë të rëndë". Hasani ka kërkuar që

autorët "të mbahen përgjegjës për ekspozitën, mashtrimin e institucioneve dhe organet e drejtësisë ta kryejnë punën e vet sipas ligjit". "Ajo që është prezantuar në këtë ekspozitë më datën 24 mars 2026 nuk është vetëm gabim, është prezantim i qëllimshëm i deklaratimeve të UDB-së të asaj kohe. Kjo është fyerje për viktimat. Është fyerje për të burgosurit dhe të mbijetuarit. Është fyerje për të vërtetën e masakrës në Burgun e Dubravës. Sepse kur një shqiptar del dhe thotë në libër e në ekspozitë të financuar nga buxheti i shtetit dhe paraja publike, se në Burgun e Dubravës ka pasur kryengritje të të burgosurve dhe janë vranë 48 ushtarë të burgosur të armatosur dhe 58 të burgosur civilë, ai nuk ka treguar të vërtetën; ai ka prezantuar sot, pas 27 viteve të masakrës në Burgun e Dubravës, në sheshin e Prishtinës, propagandën e aparatit kriminal serb mbi masakrën në burgun e Dubravës", ka thënë Hasani. "Admovere" dhe "Integra", dy organizatat që drejtohen nga Shkëlzen Gashi dhe Kushtrim Koliqi, u kanë kërkuar falje të dielën familjarëve të viktimave civile, ndërsa kanë bërë thirrje për "diskutim të hapur" për ta adresuar këtë çështje. Hasani ka thënë se kjo është "e pamjaftueshme, sepse dëmi politik është bërë me prezantimin e versionit të UDB-së". "Kjo ekspozitë e 'Integra' dhe 'Admovere' është me pasojë të

rënda politike për Kosovën dhe kërkimfalja e Shkëlzenit nuk e riparon dëmin e shkaktuar për shtetin tonë dhe për të vërtetën e masakrës së Dubravës", ka thënë Hasani, duke kërkuar nxjerrjen e një ligji për "mbrojtjen e vlerave të luftës çlirimtare të Kosovës". "Si grup parlamentar i PDK-së, unë edhe si ish-i burgosur dhe i mbijetuar i masakrës së Burgut të Dubravës, kundërshtojmë këtë narrativë serbe të paraqitur nga Shkëlzen Gashi në ekspozitën e tij në sheshin 'Nënë Tereza' në Prishtinë dhe kërkojmë përgjegjësi politike. Lavdi të rënëve në Burgun e Dubravës dhe të gjithë të rënëve në Kosovë", ka thënë Hasani. Ndërsa deputetja e AAK-së, Time Kadriaj, ka kërkuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës që libri i Shkëlzen Gashit të tërhiqet nga ambasadat dhe të sillet ligji për vlerat e luftës. "E lus Andin Hotin si ministër: bëje një ligj për mbrojtjen e vlerave të luftës, si djalë i Ukshin Hotit, fati i të cilit nuk dihet. Historia nuk ndryshohet. Nuk mund të ndryshohet me linçimet dhe organizimet që jeni duke i bërë. Tërhiqeni edhe librin për masakrat në Kosovë të Shkëlzen Gashit, i cili ka shkruar të pavërteta dhe është blerë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe është shpërndarë nëpër vendet e tjera. Vetë shteti i Kosovës ka shpërndarë libra me të pavërteta në vende të ndryshme të botës", ka thënë Kadriaj.



ÇËSHTJA E PRESIDENTIT: LV-ja BËN THIRRJE PËR BASHKËPUNIM, PDK-ja DHE AAK-ja AKUZOJNË PUSHTETIN PËR ZVARRITJE TË PROCESIT

Lëvizja Vetëvendosje ka bërë thirrje për bashkëpunim ndërpartiak për zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës ndonëse nuk ka ndërmarrë asnjë hap që nga aktgjykimi i Kushtetueses. Lideri i LV-së dhe kryeministri Albin Kurti ka thënë se vendi nuk ka luks për vonesa dhe bllokada, ndërsa PDK-ja dhe AAK-ja e kanë akuzuar partinë në pushtet se është duke e zvarritur qëllimshëm procesin e zgjedhjes së presidentit

**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

PRISHTINË, 2 PRILL - Partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje (LV), ka bërë thirrje për bashkëpunim ndërpartiak për zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës, por ajo është akuzuar nga Partia Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) se po e zvarrit procesin "qëllimshëm", pavarësisht se po rrjedh një afat kushtetues për këtë. Duke folur në seancën parlamentare të enjten,

kryeministri Albin Kurti, njëherësh kryetar i LV-së, ka bërë thirrje për bashkëpunim, duke thënë se vendi nuk ka luks për vonesa e bllokada. "Tani na duhet të punojmë sa më shumë që të mundemi së bashku, e jo të kemi bllokada të reja. Bllokadat, grackat, kleçkat, taktikat nuk janë mendësi e zhvillimit, por e ngecjes. Koha që të ecim përpara dhe të jemi në krye të detyrës", ka thënë Kurti.

Javën e kaluar Gjykata Kushtetuese u ka dhënë deputetëve 34 ditë kohë për ta

zgjedhur kreun e shtetit, në të kundërtën vendi shkon në zgjedhje të parakohshme, që duhet të mbahen brenda 45 ditësh.

Presidentes së tanishme, Vjosa Osmani, i mbaron mandati më 4 prill dhe nëse deri atëherë nuk zgjidhet presidenti i ri, detyrën e presidentit do ta ushtrojë kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu.

Deputeti i PDK-së, Përparim Gruda, ka akuzuar kryeministrin Kurti dhe LV-në për agjendë të fshehur për bllokimin e zgjedhjes së presidentit të ri. Në një bisedë për "RTV21", deputeti Gruda ka thënë se presidenti i ri do të duhej të zgjidhej përpara përfundimit të mandatit të presidentes Vjosa Osmani. "Më 4 prill përfundon mandati i presidentes aktuale dhe vendi kalon në ushtrues detyre të presidentit. Mendoj se vendi është dashur të ketë president para se t'i përfundojë mandati

siç e kërkon Kushtetuta që të mos shkohet me ushtrues detyre të presidentit sepse u. d. i presidentit është gjendje jonormale. Kjo vonesë që po ndodh, pra u konsumua një javë dhe nuk ka asnjë hap për zgjedhjen e presidentit, është e papranueshme dhe tregon që ka një agjendë që të mos arrihet deri te zgjedhja e presidentit, por të mbahet vendi i bllokuar", ka thënë Gruda.

Deputeti Gruda ka thënë se Kurti ka synim ta zvarrisë zgjedhjen e presidentit për ta vendosur kryetaren e Kuvendit, Albulena Haxhiu, ushtruese e detyrës së presidentes. "Synimi është ky që në fundjavë Albulena Haxhiu, sipas Kushtetutës, bëhet ushtruese e detyrës së presidentit, prandaj këtyre nuk iu ngutet. Por, vendi nuk duhet të jetë me u. d. të presidentit, ose duhet ta zgjedhim presidentin ose të shkojmë në zgjedhje. Tash fakti që e mbajnë me u. d. të

president tregon se krejt qëllimi ky ka qenë. Edhe kërkesa e afatit shtesë nga Gjykata Kushtetuese ka qenë qëllimi që ta marrin në kontroll atë institucion efektivisht, që ta bëjnë Albulena Haxhiun u. d. të presidentit për ta vazhduar lojën tjetër politike. Shpresoj të kthehen te diskutimet dhe debatet normale", ka thënë Gruda.

Deputeti Gruda ka thënë se nuk kanë pranuar ende ftesë nga Kurti për takim. Por, sipas tij, pa marrëveshje politike PDK nuk ka votë për kandidatët e LV-së për president. "S'kemi marrë ftesë deri sot. Kur ta marrim ftesën do të marrim një qëndrim të organeve të partisë. Pa marrëveshje normalisht nuk do të ketë votë dhe nuk mendoj se ka përpjekje serioze për ta zgjedhur presidentin. Nëse nuk zgjidhet presidenti, ne shkojmë drejt zgjedhjeve. Nuk është më në dorën dhe vullnetin tonë. Nëse nuk ka zgjidhje prej

KURTI 'GODET' OSMANIN: VULLNETI I POPULLIT NUK ANULOHET ME DEKRET

PRISHTINË, 2 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka folur në Kuvend për çështjen e presidentit ku ka thënë se dekreti ishte në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. Kurti ka thënë se dekreti i presidentes Vjosa Osmani për shpërndarjen e Kuvendit kishte krijuar konfuzion në vend që ta qartësonte këtë çështje. "Mirë se gjejmë njëri-tjetrin në seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ka krijuar një situatë e cila kërkon qartësi jo konfuzion, e cila kërkon përgjegjësi, jo shmangie. Gjykata Kushtetuese ka folur për natyrën e Republikës sonë demokratike parlamentare dhe



për kufijtë që Kushtetuta i vendos çdo institucioni", ka thënë Kurti. Sipas tij, shpërndarja e Kuvendit nuk është instrument për të tejkaluar vështirësi politike. "Në këtë rend, shpërndarja

Kuvendit nuk është instrument për të tejkaluar vështirësi politike dhe, mbi të gjitha, është vërtetuar e dëshmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese tani që presidenti nuk mund ta shpërndajë vullnetin e popullit as nën presion të afateve e të paqartësive kushtetuese. Vullneti i popullit nuk anulohet me dekrete dhe rrjedhimisht as nuk shpërndahet. Tani pas qartësimit dhe vërtetimit të kësaj të vërtete të pamohueshme, sot nuk kemi një boshllëk institucional përpara nesh, por kemi një detyrë të qartë", është shprehur Kurti.

I pari i ekzekutivit ka thënë se demokracia nuk mbahet në këmbë e nuk avancohet përpara, duke e bllokuar punën dhe funksionin e njëra-tjetrës. "Kuvendi është funksional dhe i kthehet punës së tij, mandati i deputetëve është i gjallë dhe

përgjegjësia ndaj proceseve, politikave publike është edhe më e madhe. Afatet kushtetuese janë në rrjedhë, shteti nuk ka ndalur së vepruari dhe nuk ka asnjë arsye që ne ta ndalim atë. Përkundrazi, çdo përpjekje për ta ndërprerë këtë funksionim do të ishte jo vetëm politikisht e gabuar, por edhe një precedent që cenon vetë idenë e ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Demokracia nuk mbahet në këmbë e nuk avancohet përpara duke e bllokuar punën dhe funksionin e njëra-tjetrës, por duke e respektuar çdo pushtet tjetër brenda kufijve të përcaktuar nga vetë Kushtetuta. Kjo nuk është asnjë çështje abstrakte apo debat teorik. Vazhdimi i punës së institucioneve tona është më konkret se kurrë, njëkohësisht edhe më i nevojshëm se asnjëherë", ka thënë Kurti.

GLPS-ja: MOSEMËRIMI I SEKRETARIT TË KUVENDIT DHE VENDIMI PËR RISHPALLJE TË KONKURISIT, SHKELJE LIGJORE

PRISHTINË, 2 PRILL - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka shprehur shqetësim lidhur me, siç ka vlerësuar, paligjshmërinë e vendimit të datës 30 mars 2026 të marrë nga Kryesia e Kuvendit për rishpalljen e konkursit për pozitën e sekretarit të përgjithshëm të këtij institucioni. GLPS-ja ka reaguar edhe më herët për këtë çështje, më 5 mars, duke i bërë me dije Kuvendit se procesi i rekrutimit është monitoruar në të gjitha fazat e tij dhe nuk janë evidentuar shkelje që do të cenonin ligjshmërinë apo meritokracinë e këtij procesi. "Ky vendim në vetvete përcillet me një sërë shkeljesh ligjore duke filluar nga dështimi i Kryesisë për të përzgjedhur njërin nga kandidatët e ligjshëm për Sekretar të Përgjithshëm,

anashkalimi me votë i një procesi të ligjshëm edhe pse legjislacioni në fuqi nuk e jep këtë lloj autorizimi që Kryesia mund të vendos që asnjëri kandidat mos të emërohet, dhe rishpallja e konkursit pa u përfunduar procedura e cila është e ligjshme. Anulimi i këtij procesi mbi bazën e vetme të mungesës së votave dhe pa u plotësuar dhe verifikuar asnjë shkelje ligjore që qon në paligjshmëri të këtij procesi përbën një precedent të rrezikshëm që minon drejtpërdrejt parimet themelore të shërbimit civil siç janë: meritokracia, profesionalizmi, depolitizimi dhe mosdiskriminimi. Për më tepër, një veprim i tillë cenon të drejtat dhe pritshmëritë e ligjshme të kandidatëve fitues të këtij



procesi dhe dekurajon kandidatët që të konkurrojnë për këtë pozitë në të ardhmen", është thënë në reagimin e GLPS-së. GLPS-ja ka theksuar se në këtë rast, roli i Kryesisë së Kuvendit

është në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të përcaktuar sipas legjislacionit për zyrtarët publikë dhe "kursesi si trup politik e cila ka diskrecion politik që me votë mund të

shmangë një proces të ligjshëm të rekrutimit". "Mbi bazën e këtij precedenti të paligjshëm mund të vijmë në situata të përsëritura në të ardhmen që shumë procedura të rekrutimit të dështohen qëllimisht nga Kryesia mbi bazën e 'mungesës së votave', është thënë në reagimin e GLPS-së.

GLPS-ja i ka bërë thirrje Kryesisë së Kuvendit që të rishqyrtojë këtë vendim dhe të veprojë në përputhje me ligjin, "duke përmbyllur procesin përmes emërimit të njërit nga kandidatët fitues". "Çdo veprim tjetër përveç këtij, jo vetëm që është i paligjshëm, por përbën edhe cenim të rendit juridik dhe të rregullave dhe parimeve të pranimit në shërbimin civil", është thënë në reagimin e GLPS-së.

partisë që ka shumicën e votave. Pa Vetëvendosjen nuk zgjidhet presidenti, pa njërin prej neve të opozitës mundet. Ne kemi pasur një propozim që të na lë neve ta propozojmë kandidatin, por nuk është pranuar", ka thënë Gruda. Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka akuzuar partinë e Kurtit se po e zvarrit procesin e zgjedhjes së presidentit të ri për interesat e veta. "LV-ja e ka një plan në kohë. Për ta është me rëndësi që kryetarja e Kuvendit të jetë edhe ushtruese e detyrës së presidentit, prandaj nuk po nguten. Pastaj mbetet të shihet se si do ta menaxhojnë situatën, por ne varem nga iniciativa e tyre", ka thënë Haradinaj. Megjithatë afati kushtetues po rrjedh, partitë parlamentare nuk kanë bërë ndonjë hap deri tani drejt arritjes së

pajtuësorisë për presidentin e ri. Haradinaj ka thënë se partia e tij, e cila ka 6 vende në Kuvend, nuk ka vendosur si të veprojë, në pritje të një lëvizjeje nga Kurti. "AAK-ja i ka votat, janë gjashtë, por ende nuk janë të përcaktuara se si do të veprohet. Nuk kemi asnjë zhvillim konkret dhe është e qartë që gjithçka lidhet me kohën, pra të shkojë Osmani, me qenë ushtruese e detyrës Haxhiu, dhe pastaj të shohim se çfarë do të bëjnë", ka thënë Haradinaj. Kurti u ka thënë ligjvënësve të enjten se vendi nuk ka nevojë për zgjedhje të reja parlamentare të serishme "si ikje nga përgjegjësia që na takon". Zgjedhja e presidentit të ri dështoi në fillim të muajit të

kaluar pikërisht për shkak të mungesës së një marrëveshjeje mes partive. Dy kandidatët të paraqitur nga partia në pushtet, Glauk Konjufca dhe Fatmire Kollçaku-Mullhaxha, nuk u hodhën fare në votim në mungesë të kuorumit gjatë një seance më 5 mars. Për partitë opozitare, dy emrat e paraqitur nga partia në pushtet ishin të papranueshëm dhe ato këmbëngulën në marrëveshje politike ose të paraqitej një emër i pranueshëm për të gjithë. Vetë Osmani e synonte edhe një mandat të dytë, mirëpo ajo nuk ka gëzuar mbështetjen e partive. Presidenti i Kosovës zgjidhet me dy të tretat e votave në dy raundet e para apo me 61 vota në raundin e tretë, por nevojiten 80 deputetë në sallë që seanca të mund të mbahet.

Çitaku: Kompromisi për LV-në është fjalë e ndytë

Nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Vlora Çitaku, ka thënë për medie se për Lëvizjen Vetëvendosje "kompromisi" futet në fjalorin e "fjalëve të ndyta". Kështu ka deklaruar ajo e pyetur për çështjen e presidentit, i cili duhet të zgjidhet më së largu deri në fund të muajit prill ose vendi shkon në zgjedhje. Çitaku ka thënë se vështirë se do të gjendet pajtim me Vetëvendosjen referuar edhe moskallimit të propozimrezolutës së PDK-së

për "shtrembërimin" historik të fakteve në ekspozitën e Shkëlzen Gashit. "Tash e një kohë të gjatë nga LV-ja dhe nga shumica parlamentare që e kemi sot kompromisi shihet si dobësi e marrëveshja si fjalë e ndyrë dhe mirë, saktë e keni, kur ne nuk kemi parë sot vullnet politik nga Lëvizja Vetëvendosje për t'u pajtuar për një çështjeje e cila nuk do të duhej të kishte fare diskutim, është e vështirë të besojmë që ka vullnet politik për t'u pajtuar për çështje të tjera", ka theksuar Çitaku.

Buzhala largohet nga "Guxo": Nuk më mjafton të jem veç anëtar i thjeshtë

PRISHTINE, 2 PRILL - Ish-kandidati për deputet në listën e Vetëvendosjes, Viktor Buzhala, pas tre muajsh aderim në partinë "Guxo" të Donika Gërvallës dhe Faton Pecit, ka njoftuar për dorëheqjen nga kjo parti. Buzhala ka thënë se ka dhënë dorëheqje nga "Guxo" duke thënë se "nuk më mjafton të jem veç një anëtar i thjeshtë".

"Kam vendosur të largohem nga partia 'Guxo'. Nuk më mjafton, as nuk më plotëson të qenurit vetëm anëtar i thjeshtë i një partie politike. Për të hyrë në politikë më është dashur të sakrifikoja shumë në aspektin personal. Qëllimi i vetëm ishte të kontribuoja. Deri tash, nuk mu dha ajo mundësi. Siç e dini unë nuk arrita të bëhem deputet,

nuk jam pjesë e asnjë dikasteri qeveritar apo institucional, sikurse nuk jam pjesë e asnjë strukture të 'Guxo', pra nuk më është dhënë apo ofruar asnjë përgjegjësi aty. E kjo situatë, ku unë mbetem totalisht i paangazhuar, duke konsideruar që mundësia për të kontribuar nga këndi i anëtarit të thjeshtë të një partie është zero, bie ndesh

totalisht me atë për çfarë unë jam angazhuar në politikë. Dua ta falënderoj bashkëkryetaren e 'Guxo', zonjën Donika Gërvalla për mbështetjen që ma ka dhënë që nga dita e parë. Për fund, me duhet të sqaroj që bindjet e mia politike mbesin të njëjta dhe ndërmend me i ndryshuar nuk e kam", ka njoftuar Buzhala.



GJERMANIA NDIHMON FSK-në ME TRE MILIONË EURO DONACION

PRISHTINE, 2 PRILL - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka pritur në takim ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Rainer Rudolph, me ç'rast është zyrtarizuar pranimi i një donacioni në vlerë prej 3 milionë eurosh nga Ministria e Mbrojtjes e Gjermanisë. Ky donacion do të shërbejë për realizimin e pesë projekteve konkrete, me fokus në plotësimin e flotës së transportit ushtarak dhe zhvillimin e kapaciteteve të mbështetjes mjekësore. Për këtë takim ka raportuar edhe Ambasada e Gjermanisë në Kosovë.

"Gjermania vazhdon të qëndrojë krah për krah me Kosovën në forcimin e sigurisë dhe

qëndrueshmërisë", ka njoftuar Ambasada e Gjermanisë. Sipas kësaj ambasade, ambasadori ka "theksuar mbështetjen e vazhdueshme të Gjermanisë në kuadër të iniciativës 'Enable and Enhance', me 3 milionë euro në vitin 2026 për pesë projekte kyçe". "Këto projekte fokusohen në forcimin e shërbimeve mjekësore, logjistikës dhe kapaciteteve të zjarrfikjes brenda Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), kontribute konkrete që rrisin gatishmërinë operacionale dhe zhvillimin institucional. Takimi përfshiu gjithashtu asistencën e vazhdueshme të Gjermanisë për trajnimin ushtarak: kadetët kosovarë, që aktualisht po ndjekin



trajnim gjuhësor në Gjermani, do të vazhdojnë me arsimimin për oficerë në përpunime me standardet e NATO-s, një investim në gjeneratën e ardhshme të lidershit brenda FSK-së. Përveç kësaj, programi bilateral për vitin 2026 parasheh një gamë të gjerë aktiviteteve të përbashkëta, duke përfshirë shkëmbime ekspertësh dhe trajnime në logjistikë, polici ushtarak dhe arsimim për oficerë. Gjermania ka qenë një partner i besueshëm për FSK-në që nga fillimi dhe mbetet e përkushtuar për thellimin e këtij bashkëpunimi dhe për mbështetjen e Kosovës në rrugën e saj drejt integritimit euroatlantik", ka njoftuar Ambasada e Gjermanisë në Kosovë.

PROKURORJA PULA MORI PJESË NË TRYEZËN MBI DEZINFORMIMIN NË PERIUdhË ZGJEDHORE

PRISHTINE, 2 PRILL - Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje, prokurorja Laura Pula, ka marrë pjesë si paneliste në tryezën me temë "Institucionet përballë dezinformimit në periudhë zgjedhore", në Ditën Ndërkombëtare të Verifikimit të Fakteve në kuadër të së cilës u paraqit edhe raporti mbi reziliencën ndaj dezinformatave gjatë proceseve zgjedhore në Kosovë. Ky raport është hartuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe është organizuar nga "ADS/Hibrid.info". Me këtë rast, Pula ka vlerësuar punën e bërë në hartimin e raportit, duke theksuar rëndësinë e trajtimit të dukurisë së dezinformimit gjatë periudhës zgjedhore, si një prej



sfidave serioze që mund të ndikojnë në informimin e drejtë të opinionit publik dhe në integritetin e proceseve demokratike. Gjatë diskutimit, prokurorja Pula

ka folur për sfidat me të cilat përballlet Prokurori i Shtetit në trajtimin e rasteve që ndërlidhen me dezinformimin në procese zgjedhore. Ajo ka theksuar se ndër vështirësitë kryesore mbeten

përcaktimi i përgjegjësive penale, vendosja e kufirit ndërmjet dezinformimit dhe lirisë së shprehjes, si dhe dëshmimi i qëllimit kriminal apo i elementeve të përgjegjësive penale. Në këtë kontekst, Pula ka nënvizuar se sfidë e veçantë paraqet edhe identifikimi i autorëve të përmbajtjeve dezinformuese për shkak të përdorimit të profileve të rreme apo anonime, rrjeteve private virtuale, si dhe shpërndarjes masive të përmbajtjeve nga shumë përdorues, shpesh pa mundësi të qartë për ta përcaktuar burimin origjinal. Po ashtu, ajo ka theksuar se përfshirja e platformave globale krijon vështirësi në trajtimin e këtyre rasteve, që gjithë kërkon

bashkëpunim jo vetëm ndër-institucional, por edhe bashkëpunim juridik ndërkombëtar. Më tutje, prokurorja Pula ka thënë se amplifikimi i dezinformatave, përmes shpërndarjes së koordinuar të informacionit të rremë, ka prodhuar në shumë raste ndikim të konsiderueshëm në opinionin publik, me theks të veçantë te votuesit gjatë periudhëve zgjedhore. Pula ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim me të gjithë aktorët institucionale dhe organizatat relevante, me qëllim të forcimit të përpjekjeve të përbashkëta për të garantuar informim të drejtë dhe të saktë të opinionit publik gjatë proceseve zgjedhore.

LDK-ja bëhet me tre sekretarë partie

PRISHTINE, 2 PRILL - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, në bazë të autorizimeve të marra nga Kuvendi i LDK-së dhe në përputhje me orientimet e përcaktuara në Deklaratën Politike të miratuar nga Kuvendi i fundit i partisë, ka marrë vendim për emërimet në disa pozita të rëndësishme organizative të LDK-së. Në këtë kuadër, Abdixhiku ka emëruar tre sekretarë të LDK-së. Ilir Ferati

është emëruar në detyrën e sekretarit të përgjithshëm të LDK-së, me përgjegjësi për drejtimin dhe koordinimin e aparatit institucional dhe administrativ të partisë, si dhe për sigurimin e zbatimit të rregullt të vendimeve të organeve drejtuese të saj. Sokol Haliti është emëruar në detyrën e sekretarit për mërgatë të LDK-së, me përgjegjësi për forcimin e lidhjes së partisë me mërgatën, organizimin dhe përfshirjen e saj

aktive në jetën politike dhe zhvillimore të vendit. Dhe Visar Azemi është emëruar në detyrën e sekretarit organizativ të LDK-së, me përgjegjësi për koordinimin e strukturave organizative të partisë dhe për forcimin e funksionimit të saj në të gjitha nivelet. "Këto emërimet janë pjesë e fazës së konsolidimit organizativ dhe politik të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në përputhje me orientimet e përcaktuara nga Kuvendi i fundit

i partisë. Me këtë rast, kryetari Abdixhiku ka shprehur mirënjohje dhe falënderim për Imri Ahmetin, i cili deri në Kuvendin e fundit të LDK-së ka ushtruar me integritet dhe përkushtim detyrën e sekretarit të partisë, duke dhënë një kontribut të çmuar në funksionimin institucional dhe organizativ të saj. Po ashtu, kryetari Abdixhiku së shpejti do të prezantojë edhe përbërjen e re të Kryesisë së LDK-së, si pjesë e



procesit të riorganizimit dhe fuqizimit të mëtejshëm të strukturave drejtuese të partisë", ka njoftuar LDK-ja.

KËRKESA PËR PROVA TË REJA, CENIM I SIGURISË JURIDIKE DHE SHKELJE E RREGULLAVE BAZË TË PROCEDURËS



Shkruan: Ardian
BAJRAKTARI

Në procesin gjyqësor ndaj katërshes së UÇK-së në Hagë, Prokuroria po tenton ta cenojë sigurinë juridike, parimin e kontradiktës së procedurës, të drejtën për mbrojtje efektive juridike si dhe integritetin e

procesit gjyqësor. Rregulla 136 e Rregullores së Procedurës dhe Provave, rregullon në mënyrë të qartë momentin e mbylljes së çështjes gjyqësore dhe kufijtë procedural pas deklaratave përmblyëse. Sipas kësaj rregulle, pas deklaratave përmblyëse, Kryetari i Trupit Gjyqësor e deklaron të mbyllur çështjen, veprim i cili më 18 shkurt 2026 është bërë dhe se pas kësaj faze, Trupit gjyqësor nuk mund t'i paraqitet asnjë parashtrim tjetër, përveç në rrethana të veçanta dhe me arsye të vlefshme. Po ashtu, Trupi gjyqësor nuk mund të pranojë prova apo të dëgjojë dëshmi të tjera, përveç nëse kjo

diktohet nga rrethana të jashtëzakonshme. Në procesin gjyqësor ndaj z. Thaçi dhe të tjerëve, paraqitja e provave apo parashtrimeve të tjera, pas shpalljes së mbylljes së çështjes përbën devijim të drejtpërdrejtë nga Rregulla 136. Për më tepër, duhet vlerësuar nëse është konstatuar ekzistimi i rrethanave të veçanta, po ashtu, nëse është dhënë arsyetim i detajuar dhe specifik mbi domosdoshmërinë e pranimit të materialit të ri, pastaj nëse është rihapur formalisht shqyrtimi gjyqësor, si dhe nëse Mbrojtjes i është garantuar mundësi reale dhe efektive për kundërshtim të plotë të

materialit. Kjo rregull, nuk është formalitet procedural, por ka karakter garantues, përmes saj mishërohet parimi i përfundimit procedural dhe, mbi të gjitha, mbrohet barazia e armëve ndërmjet palëve në procedurë. Fakti që prokuroria ka pasur kohë të mjaftueshme në dispozicion, madje dukshëm më shumë se mbrojtja, e bën vështirë të besueshme përmbushjen e kushteve të cekura më lart për pranimin e çfarëdo materiali të dorëzuar nga ana e saj pasi është konstatuar mbyllja e procesit nga ana e trupit gjyqësor. Në procese gjyqësore me kompleksitet të lartë dhe rëndësi të veçantë

publike, si ato ndaj katërshes së UÇK-së, respektimi rigoroz i fazave procedurale është thelbësor për legjitimitetin e vendimmarrjes.

Çdo devijim nga Rregulla 136 e Rregullores së Procedurës dhe Provave, është shkelje thelbësore e procedurës, e cila pashmangshëm do të ndikonte në garantimin e një vendimi të drejtë gjyqësor.

Pranimi eventual i çfarëdo materiali të Prokurorisë pas 18 shkurtit 2026, do ta cenonte sigurinë juridike, parimin e kontradiktës së procedurës, të drejtën për mbrojtje efektive dhe integritetin e procesit gjyqësor.

ABSURDITETI I GJYKATËS SPECIALES IA LEJON ZPS-së TË DORËZOJË ENDE MATERIALE

HAGË, 2 PRILL - Trupi gjyqësor në rastin e Hashim Thaçit dhe të tjerëve ka vendosur edhe për një çështje në favor të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS), duke lejuar dorëzimin e materialeve edhe pasi procesi gjyqësor është përmblytur. Sipas vendimit të Gjykatës Speciale, ZPS-ja ka dorëzuar materiale më 4 dhe 10 mars por që, sipas vendimit, nuk ka prova të reja në procedurë. "Paneli vëren se mbrojtja e Thaçit e ngre këtë argument për herë të parë në Përgjigjen e saj dhe, në kundërshtim me Rregullin 76, këto argumente nuk adresojnë asnjë çështje të ngritur nga ZPS-ja në përgjigje. Sidoqoftë, Paneli vëren se Rregulli 139 përcakton qartë cilat prova do të shqyrtojnë Paneli për qëllimet e vendimit dhe siç u tha nga gjyqtari i procedurës paraprake, një panel gjyqtarësh profesionistë mund të vlerësojë vetëm provat e pranuar para tij në gjyq. Nëse ato janë, siç pretendohet nga mbrojtja, inkriminuese apo, siç etiketohen nga ZPS-ja, shfajësuese, është pra e parëndësishme dhe mbrojtja nuk ka arritur të tregojë ndonjë paragjykim që do të kërkonte një lehtësim. Prandaj, këto argumente hidhen poshtë. Për dallim nga parashtrimet e mbrojtjes, paneli gjen se dorëzimi nuk përbën parashtrim apo prova drejtuar panelit në kuadër të këtij rregulli", është thënë në vendimin e Speciales. Gjykimi në rastin e krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, ka përfunduar. Edhe vetë gjyqtarët kishin theksuar se asnjë material i ri nuk mund të dorëzohet, përveç në rrethana të jashtëzakonshme. Pavarësisht prej kësaj, Prokuroria e Hagës ka vazhduar



deponimin e disa provave e dokumenteve lidhur me këtë rast. Kjo është bërë me dije në një ankesë që është dorëzuar nga mbrojtja e Hashim Thaçit. Në ankesën e mbrojtjes së Thaçit është thënë se prokuroria ka dorëzuar materiale më 4 mars, 10 mars dhe 11 mars, pavarësisht se gjykimi ka përfunduar. "Më 18 shkurt 2026, trupit gjyqësor e mbylli çështjen në përputhje me Rregullin 136 dhe deklaroi shprehimisht se "në përputhje me Rregullin 136, nuk mund të bëhen më paraqitje apo të dorëzohen prova të tjera para trupit në këtë fazë, përveç në rrethana të

jashtëzakonshme dhe kur ekziston arsye e justifikuar. Kjo, natyrisht, nuk përfshin çështjet që duhet të rishikohen rregullisht, siç është paraburgimi", është thënë në ankesën e mbrojtjes së Thaçit. Sipas mbrojtjes, nuk lejohet që edhe më tutje të dërgohen prova të tilla. "Për më tepër, arsyetimi në vendimin kornizë për t'i dhënë qasje gjykatësit të procedurës paraprake (dhe më pas trupit gjyqësor) në nxjerrjet e materialeve sipas Rregullave 102 dhe 103 nuk vlen më. Gjykatësi i procedurës paraprake kishte konstatuar se duhej të merrte kopje të këtyre nxjerrjeve të

materialeve për shkak të "detyrës së tij për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për përgatitjen e shpejtë të çështjes për gjykim" dhe për të siguruar që 'provat relevante, qoftë ato të rëndësishme për përgatitjen e Mbrojtjes apo potencialisht shfajësuese, të zbulohen brenda afatit të caktuar'. Këto shqetësime nuk vlejnjë më, duke qenë se procedurat tashmë janë mbyllur. Nëse ZPS-ja zbulon materiale shfajësuese që kërkojnë rihapjen e çështjes, i takon mbrojtjes të paraqesë një kërkesë në përputhje me rregullin 136 dhe të dëshmojë arsye të justifikuar dhe rrethana

të jashtëzakonshme për pranimin e atij materiali si prove", është thënë në këtë ankesë.

Si rezultat, mbrojtja e Thaçi ka pasur kërkesë për gjyqtarët që të mos nxirren prova të tjera. "Për arsyet e sipërpërmendura, mbrojtja i kërkon me respekt trupit gjyqësor që: të urdhërojë ZPS-në të mos bëjë zbulime të provave shtesë para trupit gjyqësor, qoftë përmes 'legal workflow' apo ndryshe, përveç nëse mund të dëshmojë arsye të justifikuar dhe rrethana të jashtëzakonshme për ta bërë këtë", është thënë në ankesën e mbrojtjes së Thaçit.

Lushaku-Sadriu për 'dallaveret' me njehsorë: Qytetarët u mashtruan

PRISHTINË, 2 PRILL - Shefja e grupit parlamentar e LDK-së, Jehona Lushaku-Sadriu, ka deklaruar se qytetari është mashtruar sa i përket shpenzimit të energjisë elektrike. Ajo ka thënë se bazuar në hulumtimet e Visar Azemit nga LDK-ja, ka dalë që njehsorë në Prishtinë dhe Ferizaj llogarisin gabim kohën. "Dua ta

ngre një temë që është shumë e rëndësishme për çdo familje të Kosovës, një çështje që ka të bëjë me një mashtrim përmes një keqlllogaritjeje të shpenzimit të energjisë elektrike. E prek secilin prej nesh. Është një padrejtësi që po bëhet për muaj apo vite me radhë", ka thënë ajo në Kuvendin e Kosovës. Në këtë

kontekst, ajo ka thënë se për shkak të llogaritjes së gabuar të njehsorëve të energjisë, qytetarët janë faturuar më shumë. "Teksa kemi dëgjuar qeverinë që u ka bërë thirrje qytetarëve ta kursejnë energjinë elektrike, të presin e të shpenzojnë prej orës 22:00, ne sot kemi parë që shumica e

njehsorëve nuk e llogarisin saktë shpenzimin e energjisë, dhe kjo çon te llogaritja më e madhe dhe faturimi më i shtrenjtë te çdo familje e Kosovës", ka thënë deputetja e LDK-së.

Deputetja Lushaku-Sadriu ka drejtuar gishtin edhe nga institucionet dhe kompanitë që



ajo ka vlerësuar se janë fajtorë për këtë çështje.

RAPORTI I FMN-së: EKONOMIA E KOSOVËS PO RRRITET MË NGADALË

PRISHTINË, 2 PRILL - Bordi Ekzekutiv i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) të enjten ka publikuar raportin vjetor për Kosovën, duke vlerësuar se ekonomia ka vazhduar të rritet, por me ritëm më të ngadalshëm, ndërsa inflacioni është rritur dhe rreziqet, veçanërisht ato nga pasiguria politike, mbeten të pranishme. Siç ka thënë FMN-ja, pas një viti me bllokadë politike, aktiviteti ekonomik është ngadalësuar. Rritja reale e Bruto Produktit të Brendshëm (BPB) ka rënë në 3.6 për qind në vitin 2025, nga 4.6 për qind në vitin 2024. Kjo sipas FMN-së, ka ardhur si pasojë e rënies së eksporteve dhe dobësimit të kërkesave nga sektori privat, por është kompensuar pjesërisht nga rritja e shpenzimeve dhe investimeve publike.

Inflacioni në Kosovë, siç ka

theksuar FMN-ja, ka vazhduar të rritet dhe ka arritur në rreth 5.7 për qind në janar të vitit 2026, kryesisht për shkak të rritjes së çmimeve të ushqimit.

Deficiti i llogarisë rrjedhëse, që tregon diferencën mes parave që hyjnë dhe dalin nga shteti, është rritur në 9.2 për qind të BPB-së, kryesisht për shkak të rritjes së importeve, sidomos të energjisë dhe ushqimit. FMN-ja ka parashikuar se rritja ekonomike në vitin 2026 pritet të jetë 3.3 për qind, ndërsa inflacioni pritet të rritet në 5.9 për qind, pastaj të bjerë gradualisht në 2 për qind deri në vitin 2028.

"Deficiti tregtar do të mbetet i lartë për shkak të importeve të mëdha. Një nga arsyet e rritjes së deficitit më 2026 pritet të jetë edhe ndalja e përkohshme e një termocentrali me qymyr për renovim", është thënë raportin e



FMN-së.

FMN-ja ka përmendur edhe rreziqet për ekonominë e Kosovës, si konfliktet në Lindjen e Mesme, tensionet në tregtinë globale, rritjen e çmimeve të produkteve bazë dhe pasigurinë politike (si për shembull zgjedhja e presidentit). Por, në anën pozitive, siç ka thënë kjo organizatë, Plani i Rritjes i

Bashkimit Evropian mund të ndikojë pozitivisht në rritje ekonomike dhe punësim nëse zbatohet me kohë.

FMN-ja i ka rekomanduar Kosovës të mos rrisë shumë shpenzimet buxhetore në vitin 2026, ta ruajë stabilitetin makroekonomik, t'i rrisë investimet publike, t'i rrisë hyrat buxhetore, ta përmirësojë

menaxhimin e financave publike, ta forcojë mbikëqyrjen e sektorit bankar, t'i monitorojë kreditë dhe tregun e patundshmërive, të bëjë reforma strukturore për ta rritur konkurrueshmërinë, ta ulë papunësinë dhe ta rrisë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës, ta zvogëlojë ekonominë joformale dhe ta përmirësojë sektorin e energjisë.

Në fund, FMN-ja ka vlerësuar se ekonomia e Kosovës ka perspektivë pozitive, por përballet me rreziqe nga situata politike dhe zhvillimet ndërkombëtare. Për këtë arsye, kërkohen reforma, kontroll i shpenzimeve dhe investime më të mençura në mënyrë që ekonomia të rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe të afrohet me standardet e BE-së.

PAGA E 13 PËR SEKTORIN PUBLIK, TAHIRI: MARRE! VENDIMI BURON NGA ZOTIMET PARAELEKTORALE

PRISHTINË, 2 PRILL - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka kritikuar Qeverinë e Kosovës për vendimin lidhur me pagën e 13, e cila është aplikuar vetëm për sektorin publik. Para fillimit të seancës së Kuvendit të Kosovës, Tahiri ka deklaruar për medie se ky vendim buron nga zotimet paraelektorale të Lëvizjes Vetëvendosje. Ai ka theksuar se qeveria duhet urgjentisht të ndërmarrë veprime konkrete në mbështetje të punëtorëve të sektorit privat, duke kërkuar trajtim më të drejtë. "E di që një ndër temat thelbësore është



paga e 13 për sektorin publik. E kam në plan ta adresoj çështjen qysh e mëtej. Rroga e 13 për publikun për 80 mijë njerëz

as nuk ka qëllim ta zbusë varfërinë as nuk ka qëllim ta ulë pabarazinë. Është vetëm një veprim që ka buruar prej

zotimit paraelektoral dhe duke ditur që mund të shkojmë në zgjedhje, mund të ketë ndonjë ndikim në votë, dhe ndikim në zgjedhjet që mund të vijnë. Ajo që u them sot të gjithë anëtarëve të kabinetit të qeverisë, është marre t'i shpërndahet paga e 13 sektorit publik e mos të ndihmohet askush nga sektori privat. Sot mendja e njerëzve që kanë pak integritet e marre është tek ai punëtori që është në ndërtimtari, ai që është në skele dhe tek ajo që është në supermarket, edhe te ju gazetarë që punoni mbi orarin

tetorësh", ka thënë Tahiri, duke shtuar se Qeveria e Kosovës urgjentisht duhet të marrë veprime për punëtorët që janë në sektorin privat. "Kjo rrogë mua as nuk më varfëron e as nuk më pasuron më shumë. Qeveria e Kosovës urgjentisht duhet të marrë veprime për punëtorët që janë në sektorin privat. Duhet të tregojë se çfarë bën për gratë dhe burrat që sot janë të mërzhitur dhe urrejnë secilin prej njerëzve që po marrin rrogë pa meritë, rrogë të 13 pa bërë asgjë. A e kemi lypë? Jo, është zotim zgjedhor elektoral", ka thënë Tahiri.

Kuvendi ratifikon disa marrëveshje financiare ndërkombëtare

PRISHTINË, 2 PRILL - Me 81 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, deputetët e Kuvendit kanë votuar disa marrëveshje financiare ndërkombëtare. Marrëveshjet e ratifikuara janë: marrëveshja financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2017, ajo për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë mes Republikës së

Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin energjia diellore fotovoltaike në KEK - Porta Globale, marrëveshja e kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për projektin e efikasitetit të energjisë në ndërtesa publike, marrëveshja për

ratifikimin e marrëveshjes së kredisë "Projekti i rrugës me shpejtësi të lartë Prishtinë - Mitrovicë" (Kredi shtesë) ndërmjet Fondit Saudit për Zhvillim dhe Republikës së Kosovës dhe marrëveshja e kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin "Implantimi për trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë".



MISIONI I NASA NJERËZIMI DO RIKTHEHET SHUMË SHPEJT NË HËNË



Njerëzimi mund të rikthehet shumë shpejt në afërsi të Hënës për herë të parë pas gjysmë shekulli.

NASA përgatitet të dërgojë astronautë në orbitën e Hënës. Në një mision të planifikuar të nisur të mërkurën në mbrëmje, astronautët Reid Wiseman, Victor Glover, Christina Koch dhe Jeremy Hansen do të ndjekin një trajektore në formë tetëshe rreth Hënës me anijen hapësinore Orion të NASA-s, një ndërmarrje e njohur si Artemis II, duke u bërë njerëzit e parë që udhëtojnë kaq larg që nga misionet Apollo të viteve 1970. Një mision i suksesshëm do të shënonte një hap vendimtar për agjencinë hapësinore, e cila synon të rikthejë njerëzit në sipërfaqen e Hënës. Ai gjithashtu do të verifikonte teknologjinë që NASA shpreson ta përdorë për misione edhe më të largëta.

“Qëllimi është të zhvendosim eksplorimin njerëzor nga orbita e Tokës drejt hapësirës së thellë,” tha astrofizikani i Harvardit,

Jonathan McDowell. “Artemis II është hera e parë që po dërgojmë njerëz në një udhëtim të tillë.”

NASA: Cila është rëndësia e Artemis II?

Për dekada me radhë, astronautët kanë udhëtuar drejt dhe nga Stacioni Ndërkombëtar Hapësinor, duke mbajtur një prani të vazhdueshme njerëzore disa qindra kilometra mbi Tokë. Tani, qëllimi i NASA-s është të ndërtojë një “prani të qëndrueshme në hapësirën e thellë”.

Programi Artemis synon të krijojë bazat për vizita të rregullta në sipërfaqen e Hënës dhe për udhëtime edhe më ambicioze në të ardhmen.

“Kjo është teknologjia që, shpresojmë, do të lejojë astronautët jo vetëm të zbresin në Hënë, por edhe të shkojnë në planetë të tjerë dhe në asteroide,” tha McDowell.

Programi mendohet të ketë

kushtuar rreth 105 miliardë dollarë gjatë 20 viteve të fundit. Misioni i parë, Artemis I, ishte një fluturim testues në vitin 2022 pa ekuipazh. Artemis II do të ketë astronautë në bord për të testuar sistemet e mbështetjes së jetës gjatë një udhëtimi të gjatë.

Ky ekuipazh do të vendosë edhe disa rekorde: Victor Glover do të jetë njeriu i parë me ngjyrë që udhëton kaq larg drejt Hënës, Christina Koch do të jetë gruaja e parë, ndërsa Jeremy Hansen do të jetë kanadezi i parë.

Çfarë sistemesh përdoren?

NASA do të përdorë raketën gjigante Space Launch System (SLS), me dy motorë të mëdhenj që gjenerojnë secili rreth 3.6 milionë paund shtytje, për të dalë nga atmosfera e Tokës.

Pas nisjes, përforcuesit ndahen dhe bien në oqean, si në raketat e mëparshme të NASA-s. SLS është ndërtuar nga kompani si

Boeing, Northrop Grumman dhe United Launch Alliance.

Anija Orion është kapsula ku qëndrojnë astronautët. Ajo mund të mbajë katër persona (më shumë se kapsulat e viteve '70) dhe ka sisteme komunikimi më të avancuara.

Çfarë ndodh pasi Orion largohet nga Toka?

Pasi ndahet nga përforcuesit, ekuipazhi do të orbitojë Tokën dy herë për të kontrolluar sistemet.

Më pas, një shtytje e fuqishme do ta çojë anijen në një orbitë të lartë rreth Tokës dhe më pas drejt Hënës, duke e nxjerrë jashtë fushës gravitacionale të Tokës, diçka që nuk ka ndodhur që nga misionet Apollo.

Udhëtimi drejt Hënës do të zgjasë rreth katër ditë. Anija do të kalojë rreth anës së largët të saj dhe më pas do të përdorë gravitetin e Hënës për t'u kthyer në Tokë, ku do të ulet në Oqeanin Paqësor.

Cilat janë sfidat?

Astronautët do të udhëtojnë më shumë se 230,000 milje larg Tokës dhe mund të ekspozohen ndaj rrezatimit diellor në rast të një shpërthimi të fortë diellor. Megjithatë, ekspertët janë më të shqetësuar për fazën e nisjes dhe rikthimit në Tokë.

Ekziston frika e një aksidenti të ngjashëm me atë të anijes Challenger në vitin 1986. Po ashtu, ka shqetësime për mburojën termike të Orion, e cila gjatë Artemis I pësoi dëmtime të papritura në mbi 100 pika.

Për këtë arsye, “pjesa më e tensionuar e misionit ka shumë gjasa të jetë rikthimi në Tokë,” tha McDowell.

NASA ka punuar për ta përforcuar mburojën dhe për të përmirësuar këndin e hyrjes në atmosferë.

Afatet për rikthimin në sipërfaqen e Hënës janë shtyrë disa herë.

Artemis III parashikohet për vitin 2027, ndërsa një mision tjetër, Artemis IV, synon zbakimin në Hënë në vitin 2028. / bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Ekipi i xhudos së Kosovës, pjesë e kampionatit stërvitor ndërkombëtar në Hungari

TATA, 2 PRILL - Në qytetin Tata në Hungari është mbajtur Kampionat stërvitor ndërkombëtar i xhudos, ku janë mbledhur sportistë elitare nga mbarë bota për të shkëmbyer përvojat dhe për të zhvilluar stërvitje në nivel të lartë profesional. Në këtë kamp ka marrë pjesë edhe ekipi i Kosovës, i përfaqësuar nga disa prej emrave

më të njohur të xhudos vendase: Distria Krasniqi, Laura Fazliu, Akil Gjakova, Flaka Loxha, Fatjona Kasapi, Erza Muminoviq, Dardan Cena, Laurinë Gashi dhe Enise Zijade. Ndërkohë ky ekip është udhëhequr nga kryemjeshtri Driton Kuka dhe trajnerja Majlinda Kelmendi, të cilët vazhdojnë të luajnë rol kyç në

zhvillimin dhe suksesin e xhudos kosovare në arenën ndërkombëtare. Ky kamp shërben si një mundësi e rëndësishme për xhudistët e Kosovës që të përballen me konkurrentë të nivelit të lartë, duke përfunduar përgatitjet për garat e ardhshme ndërkombëtare.



NORA GJAKOVA NIS KAPITULL TË RI, KAMPIONIA OLIMPIKE BËHET TRAJNERE E XHUDOS NË BELGJIKË

BRUKSEL, 2 PRILL - Një nga ikonat më të mëdha të sportit të Kosovës, Nora Gjakova, ka hapur një kapitull të ri në karrierën e saj, këtë herë jashtë tatamit si garuese. Kampionia olimpike e Tokios 2020 ka nisur zyrtarisht rrugëtimin si trajnerë në Federatën e Xhudos së Valonisë në Belgjikë. Pas tërheqjes nga sporti aktiv gjatë këtij viti, Gjakova i është bashkuar stafit të trajnerëve ku do të punojë krahas për krahas me Pedro Guedes, me synimin për t'i zhvilluar gjeneratat e reja të talentëve belgë. Dyshja njihen që më parë, pasi Guedes kishte një periudhë të shkurtër pune si trajner në Kosovë.

Nga maja e botës në një mision të ri

Gjakova mbetet një nga sportistët më të suksesshëm që ka nxjerrë Kosova. Ajo kurorëzoi



karrierën me medaljen e artë olimpike në "Tokyo 2020" në kategorinë deri në 57 kilogramë. Përveç kësaj, ajo numëron medalje të rëndësishme ndërkombëtare, përfshirë bronzin në Kampionatin Botëror në Budapest (2021), arin evropian në Tel Aviv (2018) dhe bronzin evropian në Lisbonë (2021). Në kuadër të IJF

World Tour, Gjakova ka fituar disa tituj Grand Prix dhe Grand Slam, me suksese të veçanta në Tbilisi dhe Baku, duke grumbulluar gjithsej 33 medalje në gara të nivelit botëror gjatë karrierës së saj. Paraqitja e fundit e saj erdhi në Grand Slamin e Parisit në vitin 2025, një moment që shënoi edhe fundin e një epoke.

Vendimi për t'u tërhequr

"Pas Grand Slamit në Paris e kuptova se nuk doja të garoja më. Fizikisht isha në gjendje të mirë, por mendërisht isha e lodhur. Nuk kisha më asgjë për të dëshmuar", ka thënë Gjakova. Vendimi i saj ka ardhur pas një cikli të vështirë olimpike, ku ka përjetuar edhe një lëndim serioz vetëm pesë muaj para Lojërave Olimpike. Rikthimi në formë, ka thënë ajo, ka kërkuar përkushtim ekstrem deri në gjashtë orë stërvitje në ditë. "Fillova të vë në dyshim gjithçka dhe e kuptova që nuk e doja më garën si më parë", ka thënë ajo.

Kalimi në rolin e trajneres

Hapat e parë drejt trajneres erdhën shpejt. Në janar Gjakova kishte vizituar Belgian Open në Herstal me ftesë të federatës valone, ku kishte nisur edhe bisedimet për bashkëpunim.

Marrëveshja është zyrtarizuar më 1 prill. Tashmë ajo punon çdo ditë me sportistët, duke përjetuar një ritëm të ri jetese. "Trajneria kërkon shumë kohë, por tani kur kam kohë të lirë ndihem më e relaksuar. Si sportiste gjithmonë ka presion, ndërsa tani mund të jem më produktive edhe jashtë stërvitjes", ka thënë Gjakova.

Besnike ndaj sistemit të Kosovës

Në rolin e saj të ri Gjakova mbetet besnike ndaj filozofisë së zhvilluar nga mentorët e saj shumëvjeçar, Driton Kuka, një sistem që i ka dhënë Kosovës kampione olimpike si Majlinda Kelmendi dhe Distria Krasniqi. "Unë besoj në sistemin tonë. Fokusimi në teknikë, kapje dhe disiplinë është shumë i rëndësishëm. Jam strikte me sportistët për përgatitjen, por ndoshta edhe pak më e kuptueshme", ka thënë Gjakova.

RONALDO DHE MESSI BËHEN BASHKË NË NJË REKLAMË PËR HERË TË DYTË NË HISTORI

PRISHTINË, 2 PRILL - Cristiano Ronaldo dhe Lionel Messi kanë kërcënuar sërish të "shpërthejnë" internetin, pasi janë shfaqur në një tjetër reklamë për Kupën e Botës, këtë herë së bashku me disa yje të tjerë. Dy futbollistët më të mëdhenj të të gjitha kohëve kishin bashkëpunuar edhe më parë përpara edicionit të vitit 2022 në një reklamë të "Louis Vuitton",

ndërsa tani janë ribashkuar në prag të Kupës së Botës 2026 që do të zhvillohet në Shtetet e Bashkuara. Së bashku me yjet e rinj Kylian Mbappe dhe Vinicius Junior, Ronaldo dhe Messi shfaqen në një reklamë të re të "LEGO" me sloganin "Everyone wants a piece", që promovon setet e tyre të reja koleksionuese. Të katër futbollistët paraqiten në



formë mini-figurash "LEGO", të ulur rreth një tavoline me ndriçim të zbehtë, ku në qendër ndodhet një version "LEGO"-s i trofeut

ikonik të Kupës së Botës. Tavolina fillon të rrotullohet ndërsa superyjet përpiqen ta vendosin figurën e tyre mbi trofe, një simbol që Messi arriti ta fitojë më në fund në stadiumin "Lusail" në Katar. Në fund të reklamës, një fëmijë i vogël shfaqet papritur dhe e rrëmben trofeun. Videoja është publikuar nga Messi në llogarinë e tij në "Instagram", ku fituesi tetë herë i

"Topit të Artë" përdori hashtagun: "Honestly it's not AI". Reklama është shpërndarë gjithashtu edhe nga "LEGO", që ka etiketuar Ronaldon, Mbappen dhe Viniciusin. Bashkimi i këtyre superyjeve në një reklamë të vetme konsiderohet një moment i rëndësishëm dhe, siç pritej, ka grumbulluar tashmë miliona shikime.

Yje të shumtë mbesin jashtë Botërorit

PRISHTINË, 2 PRILL - Me ndeshjet e "play-off"-it të zhvilluara këtë javë janë përcaktuar të gjitha përfaqësueset që do të jenë në Botërorin në ShBA, Kanada dhe Meksikë. Por jashtë Botërorit

kanë mbetur përfaqësueset të mëdha e, po ashtu, shumë emra të njohur të futbollit. Një prej tyre është portieri i Italisë dhe Manchester Cityt, Gianluigi Donnarumma. Italia është

eliminuar në finale të "play-off"-it nga Bosnjë-Hercegovina. Khvicha Kvaratskhelia i PSG-së dhe i Gjeorgjisë është emër tjetër i madh që mbeti jashtë ngjarjes globale. Në këtë listë

janë edhe polaku Robert Lewandowski, Victor Osimhen, Dominik Szoboszlai, Sandro Tonali, Bryan Mbuemo e plot emra të tjerë të mëdhenj futbollit.





Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 000 672, e-mail: info@npbshane.com
www.npbshane.com

Nr. i Protokollit _____

Data _____

Në bazë të dispozitave të Nenit 26 të Statutit të Ndërmarrjes Publike Banesore si dhe Nenit 9, 10 dhe 11 të Rregullores mbi dhënie me qira të pasurive komerciale të Ndërmarrjes Publike Banesore, SH.A. Prishtinë, Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. Prishtinë shpallë:

FTESE PËR APLIKIM PËR MARRJE TË PRONAVE ME QIRA

Ftoheni që të aplikoni për marrje në shfrytëzim me qira të lokaleve afariste, depove dhe garazhave pronë e Ndërmarrjes Publike Banesore, SH.A. Prishtinë. Pronat e poshtë shënuara ipen në shfrytëzim me qira personave juridik, përveç garazhave të cilat mund t'u ipen në shfrytëzim edhe personave fizik.

Pasuritë komerciale të cilat ipen me qira:

Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi €/m2 (pa TVSH)
1	Lokali 2/6a, rr. "Lidhja e Prizrenit" (Afer tregut të gjelbert)	15.24 m2	11
2	Lokali 2/14, rr. "Lidhja e Prizrenit" (Afer tregut të gjelbert)	17.28 m2	10
3	Lokali 7/2, rr. "Mbreti Justin" (Afer katedrales)	67.53 m2	14
4	Garazha 15/1 rr. "Xhavit Mitrovica" (Afer parkut të qytetit)	13.37 m2	2
5	Lokali 15/8 rr. "Xhavit Mitrovica" (Afer parkut të qytetit)	19.62 m2	4
6	Lokali 15/9 rr. "Xhavit Mitrovica" (Afer parkut të qytetit)	17.50 m2	4
7	Lokali 15/10 rr. "Xhavit Mitrovica" (Afer parkut të qytetit)	16.73 m2	4
8	Lokali 18/5, lagja "Dardania" (Përball shkollës "Xhemajl Mustafa")	61.65 m2	8
9	Lokali 22/63 rr. "Agim Ramadani" (Mbrapa galeris së arteve)	40.45 m2	12
10	Lokali 22/93 rr. "Agim Ramadani" (Mbrapa galeris së arteve)	Lokal 7.55 m2	12
		15.21 m2	6
11	Lokali 22/95, rr. "Agim Ramadani" (Mbrapa galeris së arteve)	60.43 m2	9
12	Lokali 22/96, rr. "Agim Ramadani" (Mbrapa galeris së arteve)	20.44 m2	8
13	Lokali 22/98, rr. "Agim Ramadani" (Mbrapa galeris së arteve)	21.44 m2	8
14	Lokali 22/102, rr. "Agim Ramadani" (Mbrapa galeris së arteve)	Lokal 83.66 m2	10
		Depo 100.42 m2	5
15	Lokali 22/108, rr. "Agim Ramadani" (Mbrapa galeris së arteve)	9.06 m2	9
16	Lokali nr. 27, lagja "Pejton" (Te katedralja)	29.2 m2	10

Përveç çmimit bazë, qiramarrësi do të paguaj TVSH-në, shërbimet e mirëmbajtjes dhe obligimet komunale. Periudha e qiradhënies është minimum 2 vite, me mundësi vazhdimi.

Qiramarrësi është i obliguar që para nënshkrimit të kontratës me qiradhënësin, të bëjë sigurimin e kontratës së qirasë për tre muaj më gjatë se vetë kontrata, në shumë prej katër qirave mujore neto.

Parametrat që do të shërbejnë për përzgjedhjen e aplikuesëve:

- Lloji i veprimtarisë më të volitshëm;
- Spektori investues;
- Numri i të punësuarve nga investimi;
- Plani/ Përshkrimi i Biznesit;
- Kohëzgjatja e veprimtarisë së biznesit;
- Vendi i veprimtarisë së biznesit;

Aplikuesi duhet t'i dorëzoi këto dokumenta:

- Aplikacionin për marrjen e pasurive komerciale me qira (mund ta merrni në hapësirat e NPB-së);
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të të shoqërisë tregtare apo biznesit individual pranë ARBK-aë.
- Kopjen e certifikatës së TVSH-së nëse biznesi është deklarues i TVSH-së;
- Kopjen e certifikatës Fiskale;
- Numrin e xhirologarisë bankare të biznesit apo pronarit të biznesit të nënshkruar dhe vulosur nga banka.
- Plani/ Përshkrimi i Biznesit;
- Kopjen e një dokumenti identifikues të pronarit ose të përfaqësuesit ligjor të biznesit;
- Certifikatën e solvensës së biznesit të lëshuar nga Gjykata jo më të vjetër se 6 muaj.
- Vërtetimin nga ATK-ja për pagesën e obligimeve tatimore, (personi duhet të jetë i regjistruar në ATK dhe të mos ketë borxhe tatimore);
- Fletëpagesën për aplikim.

Për aplikuesit të cilët aplikojnë për marrjen në shfrytëzim me qira të garazhave duhet që ti sjellin dokumentat sipas pikave: 1, 5, 7, 10.

Aplikacioni duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur. Në zarf (jashtë) duhet të specifikohet: emri i aplikuesit, nr. intern i patundshmërisë dhe kontaktet e aplikuesit (emaili dhe nr. i telefonit).

Tarifa e aplikimit: 10 € (Euro). Kont: BPB: 130 000 150 000 886 4 ; BKT: 190 946 698 103 119 4 ; NLB: 170 020 000 000 035 1.

Aplikacionet nuk do të merren parasysh nëse:

- Aplikuesi tashmë e ka një pasuri komerciale me qira nga Ndërmarrja Publike Banesore SH.A.Prishtinë.
- Aplikuesi ka pasur një pasuri komerciale me qira nga Ndërmarrja Publike Banesore dhe nuk i është përmbajtur kontratës së qirasë ose ka obligime ndaj Ndërmarrjes;
- Nëse aplikohet për bizneset veprimtaria e të cilave është e ndaluar me ligj në hapësirat përkatëse;
- Nëse aplikacioni nuk i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
- Nëse aplikacioni arrinë pas datës së skadimit të afatit të publikimit të shpalljes.

Personat të cilët duan t'i vizitojnë lokalet me praninë e zyrtarëve të NPB-së, si dhe të kenë qasje në hapësirat e brendshme të tyre, këtë mund ta bëjnë me datën dhe orarin si në vijim:

Numri i lokalit (sipas renditjes në tabelë)	Data	Periudha kohore
1, 2, 4, 5, 6, 7	14.04.2026	09:00 – 11:00
3, 8, 16	14.04.2026	13:00 – 15:00
9, 10, 11, 12, 13, 14, 15	15.04.2026	09:00 – 11:00

Afati për aplikim është i hapur nga data 03.04.2026 deri më date 17.04.2026

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: Ndërmarrja Publike Banesore-SH.A. në Prishtinë, rruga "Zija Shemsiu" nr. 22, lagja, "Ulpiana" - Prishtinë.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi



TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

